

# Letërnjoftimi i komunave 2023



# Letërnjoftimi i Komunave

Maj 2023

## — Përmbajtja

<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
1.1 Popullsia	6
1.2 Territori	6
1.3 Densiteti i popullsisë	7
<b>2. Arsimi</b>	<b>7</b>
<b>3. Mirëqenia Sociale</b>	<b>12</b>
<b>4. Administrata</b>	<b>13</b>
<b>5. Buxheti</b>	<b>15</b>
<b>6. Ekonomia</b>	<b>18</b>
<b>7. Shërbimet publike</b>	<b>21</b>
<b>8. Transparenca</b>	<b>24</b>

# Përmbledhje

- Në vlerësimin e popullsisë në fund të vitit 2021, Kosova ka 6,050 apo 0.34% banorë më pak krahasuar me vitin 2011. Në 20 komuna ka rënie të numrit të popullsisë, ndërsa në 18 komuna ka rritje të numrit të popullsisë krahasuar me vitin 2011. Rënia më e madhe e popullsisë ka ndodhur në komunat e Kamenicës (-27%), Obiliqit (-20%), Gjilanit (-18%) dhe Vushtrisë (-13%), Mitrovicës së Jugut (-5%), ndërsa komunat ku numri i popullsisë është rritur janë Graçanica (14%), Fushë Kosova (13%), Prishtina (10%) dhe Prizreni (9%).
- Numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në nivel vendi ka vazhduar të bie në mënyrë të vazhdueshme. Në vitin shkollor 2021/22 ishin 134,366 nxënës më pak (apo 30%) krahasuar me vitin shkollor 2008/2009. Rënia më e madhe e numrit të nxënësve ka ndodhur në komunat e Kamenicës dhe Junikut (-53%), Rahovecit, Dragashit dhe Vitisë (-45%), Gjilanit dhe Suharekës (-41%), ndërsa rritje të numrit të nxënësve ka në Fushë Kosovë dhe Novobërdë.
- Sa i përket personelit arsimor, që përfshin mësimdhënësit, personelin administrativ dhe personelin ndihmës, numri i tyre ka mbetur thuajse i njëjtë që nga viti shkollor 2013/2014, kur MASHT publikoi të dhëna të detajuara për këtë kategori. Në krahasim me vitin shkollor 2013/2014, në vitin shkollor 2021/2022, numri i mësimdhënësve ka rënë për -1%, numri i personelit ndihmës është rritur me 6%, ndërsa numri i personelit administrativ ka rënë për -3%.
- Numri i qytetarëve që marrin ndihmë sociale është më i ulët viteve të fundit. Në dhjetor të vitit 2016, numri i përgjithshëm i qytetarëve në skemat sociale ishte 107,575 persona, ndërsa në janar 2023, ky numër është për 19,672 qytetarë më pak.
- Në të gjitha komunat e Kosovës janë të punësuar 5,914 shërbyes civilë. Bazuar në numrin e popullsisë për komuna, raporti shërbyes civil-përkokë banori, më i larti del në Prizren, ku një shërbyes civil u shërben 559 qytetarëve; në Drenas ky raport është një shërbyes për 494 qytetarë; në Prishtinë 449; në Gjakovë 436; ndërsa me i ulti është në Zubin Potok, Partesh, Klllokot dhe Ranillug, ku mesatarja e shërbimit të një shërbyesi civil është deri në 88 qytetarë.
- Hendeku më i lartë gjinor në kategorinë e shërbyesve civilë është në komunat e Hanit të Elezit dhe Vitisë, ku vetëm 7% e të punësuarve janë gra, pastaj vijjnë komunat si Dragashi, Malisheva, Kamenica, Klina, Kaçaniku dhe Juniku. Ndërsa përfaqësim të barabartë ose që tejkalon të punësuarit në favor të grave janë në komunat e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës, Prishtinës dhe Zveçanit.
- Në 34 komuna të Kosovës nga 38 sa janë gjithsej, ekzistojnë 331 drejtori komunale, ku prej tyre, 98 drejtori (apo 30%) udhëhiqen nga gratë dhe 233 (apo 70%) nga burrat. Hendeku më i madh gjinor haset në Fushë Kosovë, Malishevë, Klinë, Shtërpçë, Dragash, Istog, etj. Ndarje e drejtorive në mënyrë të barabartë mes burrave dhe grave haset në Drenas dhe Han të Elezit. Komuna ku me shumë ka gra në udhëheqje të drejtorive se burra është ajo e Mamushës. Ndërsa përfaqësim më i

lartë të grave në pozita politike haset edhe në Junik, Kamenicë, Obiliq dhe Prishtinë. Ndërsa në 38 komuna të Kosovës janë 1,062 anëtarë të kuvendeve komunale. Prej tyre, 357 apo 35% janë gra dhe 705 apo 65% janë burra.

- Hendek më i madh haset në shpërndarjen e buxhetit, shikuar sipas gjinisë në sektorin publik. Gjatë një viti në gjitha komunat e Kosovës, për paga ofrohen 262,505,503 euro. Nga këto, 134,905,810 euro apo 51.4% shkojnë në pozitat e mbajtura nga burrat, dhe 127,599,693 euro apo 48.6% për pozitat e mbajtura nga gratë. Komunitat ku dukshëm shpenzohet buxheti për paga në favor të burrave janë: Ferizaj, Deçani, Hani i Elezit, Skenderaj, Podujeva, Vitia, Dragashi, Kaçaniku, Kamenica dhe Malisheva. Ndërsa komunitat ku dukshëm shpenzohet buxheti për paga në favor të grave janë: Prishtina, Peja, Gjilani, Fushë Kosova, Suhareka, Obiliqi, Gjakova dhe Mitrovica e Jugut.
- Buxheti i planifikuar i të gjitha komunave të Kosovës për vitin 2023 është 658 milionë euro. Krahasuar me një vit më herët (2022), shuma e buxhetit është rritur për 102 milionë euro apo 15.5%. Komunitat që kanë shënuar rritje të buxhetit në vlerë rreth pesë milionë euro në krahasim me vitin

paraparak janë: Fushë Kosova, Mitrovica e Jugut, Peja, Podujeva, Prishtina, Prizreni, Skenderaj, Ferizaj, Vushtrria dhe Malisheva. Kategoria me rritjen më të madhe të buxhetit gjatë 2023, krahasuar me vitin 2022, është ajo për investime kapitale. Gjatë vitit 2022, shpenzime të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale deri në vlerën 100% të shpenzimit të buxhetit kanë shënuar Ferizaj dhe Malisheva, ndërsa mbi 90% Vitia, Suhareka, Rahoveci, Obiliqi, Mitrovica e Veriut, Gjilani dhe Drenasi. Ndërsa përqindja më e ulët është shënuar në Fushë Kosovë me 26%, Prishtinë 28%, Zubin Potok 41% dhe Kllokot 42%. Përqindja e shpenzimit të buxhetit në kategorinë e kapitaleve në Fushë Kosovë dhe në Prishtinë është më e ulëta gjatë gjashtë viteve të fundit.

- Komunitat e Kosovës po përballen me një nivel të lartë të borxheve të pambledhura, të cilat nuk po arrijnë t'i mbledhin nga qytetarët dhe bizneset. Niveli më i lartë i borxhit është për tatimin në pronë. Kështu, 34 komunitat e Kosovës kanë borxh të pambledhur prej 220 milionë euro. Kjo shifër është për 20 milionë euro më e lartë në 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm. Komunitat me nivelin më të lartë të borxheve të pambledhura

është Prishtina, e cila ka afro 70 milionë euro të pambledhura. Pastaj vjen Peja me afro 22 milionë euro, Prizreni me afro 19 milionë euro, Ferizaj me 16 milionë euro, dhe Gjilani, e cila nuk ka arritur të mbledhë 13 milionë euro. Krahasimi mes vitit 2021 dhe 2022 tregon se asnjë komunë nuk ka arritur të zbresë nivelin e borxhit.

- Sipas të dhënave të ATK-së, në gjithë Kosovën deri në fund të vitit 2022 janë të punësuar 397,005 persona, apo 35,074 persona më shumë (9.7%) se një vit më herët. Sipas vlerësimit të popullsisë në vitin 2021, në Prishtinë jetojnë 219,017 banorë, ndërsa nga të dhënat e ATK-së në vitin 2022 në Prishtinë janë të punësuar 215,288 persona. Sipas të dhënave publike të ATK-së rreth aktivitetit ekonomik të binzeseve, del se në vitin 2022, bizneset me qarkullimin më të madh janë nga komuna e Prishtinës me pjesëmarrje prej 41.7% në aktivitetin e tërësishëm ekonomik në vend, Graçanicës me 10.6%, Ferizajt me 6.5%, Prizrenit me 5.6%, Fushë Kosovës me 4.4%, etj. Sipas sektorëve, në vitin 2022 del se në nivel vendi mbizotëron aktiviteti në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (48.4%), industria përpunuese (13.3%), furnizimi me rrymë (8.7%), ndërtimtaria (8.5%), etj.

Komunat e Kosovës kanë mungesë të pasqyrit dhe analizës së të dhënave krahasuese në fushat që bien në përgjegjësinë e pushtetit lokal. Kjo mungesë shkakton pamundësi vendimarrjeje të bazuar në gjendjen reale. Me qëllim për të mbuluar këtë hendek, Instituti GAP ka publikuar serinë e raporteve të quajtura 'Letërnjoftimi i Komunave' që nga viti 2009, të cilat kanë fokusuar zhvillimet kryesore nëpër komunat e Kosovës, duke ofruar të dhëna të krahasueshme ndër vite dhe mes sektorëve. Këto raporte janë hartuar duke përfshirë fusha të ndryshme që pasqyrojnë trendin e zhvillimeve komunale.

Në fushën e arsimit, raporti tregon për numrin e nxënësve në të gjitha komunat e Kosovës për tërë sistemin e arsimit parauniversitar, krahasuar mes vitit shkollor 2008/2009 me atë të 2021/2022. Në fushën e njëjtë janë ofruar të dhëna për numrin e mësimdhënësve, personelit administrativ dhe personelit ndihmës. Kjo ka shfaqur nevojën që komunat të nisin të hartojnë plane dhe të ndërmarrin nisma në adresimin e problemeve që dalin nga rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve në shkolla. Në fushën e njëjtë, raporti tregon për raportin mësimdhënës-nxënës për të gjitha nivelet e shkollimit parauniversitar. Të dhënat tregojnë se raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët në disa komuna është një mësimdhënës për 23 nxënës, ndërsa në disa komuna të tjera një mësimdhënës për nëntë nxënës.

Pozitive del të jetë rënia e numrit të qytetarëve që janë pjesë e skemave sociale. Raporti ofron të dhëna edhe në fushën e administratës lokale, buxhetit komunal, ekonomisë lokale, çështjeve sociale dhe shërbimeve publike në nivel të përgjegjësisë komunale.


**Metodologjia:** Letërnjoftimi i komunave është hartuar në bazë të burimeve zyrtare të qasshme në internet dhe kërkesave për qasje në dokumente publike. Në secilën tabelë brenda raportit është e treguar dhe cituar referenca e të dhënave të pasqyruara, sipas institucioneve përkatëse.

## 1.1 Popullsia

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), numri i popullsisë në Kosovë më 31 dhjetor 2021 ishte 1,773,971 banorë, apo 6,050 apo 0.34% banorë më pak se sa më 2011 kur është bërë regjistrimi i fundit i popullsisë.

Në 20 komuna ka rënie të numrit të popullsisë, kurse në 18 komuna ka rritje të numrit të popullsisë në krahasim me vitin 2011. Rënia më e madhe e popullsisë ka ndodhur në komunat e Kamenicës (-27%), Obiliqit (-20%), Gjilanit (-18%) dhe Vushtrisë (-13%), ndërsa komunat ku numri i popullsisë është rritur janë Graçanica (14%), Fushë Kosova (13%), Prishtina (10%) dhe Prizreni (9%).

**Fig.1** Trendet e popullsisë sipas komunave 2011-2021




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK nga regjistrimi dhe vlerësimi i popullsisë 2011 dhe 2021

## 1.2 Territori

Komuna me territorin më të madh është Komuna e Leposaviqit, gjersa komuna me territorin më të vogël është Komuna e Mitrovicës së Veriut.

**Fig.2** Territori i komunave paraqitur në kilometra katror




Burimi: Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

### 1.3 Densiteti i popullsisë

Sa i përket densitetit të popullsisë për kilometër katror, del se me pesë kilometra katrorë sa ka Komuna e Mitrovicës së Veriut ka densitetin më të lartë të popullsisë, përderisa komuna me densitetin më të ulët është Komuna e Leposaviqit e cila ka territorin më të madh në krahasim me komunat tjera, por me vetëm 17 banorë për kilometër katror. Gjashtë komunat me densitetin më të ulët të popullsisë janë komuna që banojnë me shumicë të komunitetit serb.

**Fig.3 Densiteti i popullsisë sipas komunave**




Burimi: Të dhënat e paraqitura janë krahasur bazuar në vlerësimin e popullsisë 2021 dhe madhësisë territoriale të komunave sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

## 2. Arsimi

Numri i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme në nivel vendi ka shkuar duke rënë vazhdimisht. Krahasuar me vitin shkollor 2008/2009, në vitin shkollor 2021/22 mësimin e ndjekin 134,366 nxënës më pak, apo një rënie prej 30.3%.

**Fig.4 Numri i nxënësve në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm 2008-2022**




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

Rënia e numrit të nxënësve ka ndodhur në 30 komuna të Kosovës, kurse rritje ka në vetëm tri komuna.<sup>1</sup> Komunat ku ka pasur rritje të numrit të nxënësve është Komuna e Novobërdës, e cila pas procesit të decentralizimit ka pasur rritje të popullsisë dhe territorit, rrjedhimisht edhe rritje të numrit të nxënësve; Komuna e Zveçanit, për të cilën nuk ekzistojnë të dhëna të plota, por vetëm për shkollat në gjuhën shqipe; si dhe Komuna e Fushë Kosovës e cila ka rritje të numrit të nxënësve, për shkak të rritjes së numrit të popullsisë.

Rënie më të madhe të numrit të nxënësve ka në komunat e Kamenicës dhe Junikut (-53%), Rahovecit, Dragashit dhe Vitisë (-45%), dhe Gjilanit dhe Suharekës (-41%).


**Fig. 5 Trendi i numrit të nxënësve në komuna 2008–2022**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

Sa i përket personelit arsimor (mësimdhënës, personel administrativ dhe personel ndihmës), nga viti shkollor 2013/2014, vit prej kur MASHT publikon të dhëna të detajuara për këtë kategori, numri i personelit arsimor ka mbetur thuajse i njëjtë. Në krahasim me vitin shkollor 2013/2014, në vitin shkollor 2021/2022 numri i mësimdhënësve ka rënë për 289 (-1%), numri i personelit ndihmës është rritur për 184 (6%), kurse numri i personelit administrativ ka rënë për 42 (-3%).

**Fig. 6 Trendi i numrit të personelit arsimor 2013–2022**




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

<sup>1</sup> Mungojnë të dhënat e krahasueshme për komunat: Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Kllokot, Partesh, Ranillug.



Komunat në të cilat ka pasur rënie më të madhe të numrit të mësimdhënësve janë Kamenica (-13%), Deçani (-12%), Skenderaj (-8%), Istogu dhe Gjakova (-7%). Kurse komunat që kanë rritje të numrit të mësimdhënësve janë Zveçani, Klllokoti, Juniku, Fushë Kosova, Viti, Hani i Elezit, Prishtina, Shtërpca dhe Obiliqi.


**Fig. 7 Trendi i numrit të mësimdhënësve sipas komunave 2013-2022**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

Numri i personelit administrativ ka shënuar rritje në komunat si Hani i Elezit për 60%, Mamushë 33%, Shtime 29%, Obiliq 24%, Suharekë 21%, Kamenicë 18%, Vushtrri 17%, ndërsa rënie është shënuar në Rahovec për 30%, Kaçanik 29%, Shtërpçë 25% dhe në Deçan për 19%. Përderisa në Fushë Kosovë ka rritje të numrit të nxënësve për 28%, ka rënie të personelit administrativ për 10%.


**Fig. 8 Trendi i numrit të personelit administrativ sipas komunave 2013-2022**



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

Numri i personelit ndihmës (mirëmbajtës, teknik) ka shënuar rritje pothuajse në të gjitha komunat. Kjo rritje ka ardhur pavarësisht faktit se një numër i madh i komunave i kanë privatizuar shërbimin e mirëmbajtjes së shkollave, duke kontraktuar shërbimet përmes prokurimit publik. Në Prizren kjo rritje është për 33%, Junik dhe Zveçan 25%, Vushtrri 24% dhe Suharekë 20%. Ndërsa rënie të numrit të personelit ndihmës ka në komunat si Kamenicë, Malishevë, Prishtinë, Rahovec, Kaçanik, Deçan, Novobërdë, Hani i Elezit.

**Fig. 9 Trendi i numrit të personelit ndihmës sipas komunave 2013-2022**




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e MASHT

Për vitin shkollor 2021/2022, në shkallë vendi, raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit parashkollor është 10.1, në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, ky raport është 17.6, ndërsa raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është 13.5.


Komunat me raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës në arsimin parashkollor janë Rahoveci, Prizreni, Shtimja, Klina, Mitrovica, Vushtrria, Lipjani, kurse komunat me raportin më të ulët janë Fushë Kosova, Podujeva, Kaçaniku, Istogu dhe Vitia.

**Fig. 10 Raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit parashkollor (mosha 0-5 vjeç) 2021 -2022**



Komunat me raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës në arsimin parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët janë Fushë Kosova, Prishtinë, Vushtrria, Hani i Elezit, Mitrovica e Jugut, Mamusha, Drenasi dhe Ferizaj, kurse komunat me raportin më të ulët janë Leposaviqi, Zveçani, Shtërpca, Kllokoti, Kamenica dhe Juniku.

**Fig. 11 Raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët (deri në moshën 14 vjeç)**



Komunat me raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit të mesëm të lartë janë Lipjani, Fushë Kosova, Mamusha, Podujeva, Gjakova, Ferizaj, Deçani, Mitrova e Jugut, Prishtinë, Malishevë, kurse komunat me raportin më të ulët janë Novobërda, Dragashi, Rahoveci, Vitia dhe Peja.


**Fig. 12 Raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin e arsimit i mesëm i lartë (mbi moshën 14 vjeç) 2021-2022**



### 3. Mirëqenia Sociale

Në dhjetor 2016, numri i përgjithshëm i qytetarëve që kanë qenë nën skemat sociale ka qenë 107,575 persona, ndërsa në janar 2023, ky numër është për 19,672 qytetarë më pak.


**Fig. 13** Skemat sociale të shpërndara sipas numrit të personave nga dhjetor 2016 deri në janar 2023



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Numri më i madh i qytetarëve që pranojnë ndihmë sociale bazuar në numrin e popullsisë është në Novobërdë, Zubin Potok, Kllokot, Obiliq, Shtërpçë, Ranillug, Mitrovicë e Jugut dhe Mitrovicë e Veriut, ndërsa numri më i vogël është në Mamushë, Prizren, Prishtinë, Deçan, Junik dhe Graçanicë.

**Fig. 14** Popullsia në skemën e ndihmës sociale kundrejt numrit total të popullsisë (vlerësimi 2021)




<sup>12</sup>Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

## 4. Administrata

Në të gjitha komunat e Kosovës janë të punësuar 5,914 shërbyes civilë. Bazuar në numrin e popullsisë për komuna, raporti shërbyes civil për popullsi është më i larti në komunat Prizren, Drenas, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, ndërsa më i ulti është në Zubin Potok, Partesh, Kllokot dhe Ranillug.


**Fig. 15** Shërbyes civilë për popullatë sipas komunave 2021



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe të dhëna të ASK për vlerësim të popullsisë 2021

Hendeku më i lartë gjinor në kategorinë e shërbyesve civilë është në Han të Elezit dhe Viti, ku vetëm 7% e të punësuarve janë gra. Ndërsa përfaqësim të barabartë ose që tejkalojnë të punësuarit në favor të grave janë në komunat Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Prishtinë dhe Zveçan.


**Fig. 16** Përqindja e grave në shërbimin civil sipas komunave 2021



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike

Në 34 komuna të Kosovës nga 38 sa janë gjithsej, ekzistojnë 331 drejtori komunale, ku prej tyre, 98 drejtori udhëhiqen nga gratë dhe 233 nga burrat. Hendeku më i madh gjinor haset në Fushë Kosovë, Malishevë, Klinë, Shtërpçë, Dragash, Istog, etj. Ndarje e drejtorive në mënyrë të barabartë mes burrave dhe grave haset në Drenas dhe Han të Elezit. Komuna ku me shumë ka gra në udhëheqje të drejtorive se burra është ajo e Mamushes. Ndërsa përfaqësim më i lartë të grave në pozita politike haset edhe në Junik, Kamenicë, Obiliq dhe Prishtinë. Ndërsa në 38 komuna të Kosovës janë 1,062 anëtarë të kuvendeve komunale. Prej tyre, 357 apo 35% janë gra dhe 705 apo 65% janë burra.


**Fig. 17 Numri i grave që udhëheqin drejtori komunale (maj 2023)**



Burimi: Faqet zyrtare të komunave. Pasqyrimi i drejtorive komunale. Kontrolluar në maj 2023.

Numri i të punësuarve në sektorin publik në të gjitha komunat e Kosovës deri në fund të vitit 2022 ka qenë 38,996 persona, prej tyre 19,249 (49%) gra dhe 19,747 (51%) burra. Në komunat Skenderaj, Drenas, Dragash, Kaçanik, Kamenicë, Ferizaj, Malishevë, Deçan, Rahovec dhe Shtërpçë, gjinia e të punësuarëve në sektorin publik del të jetë dukshëm më e lartë në favor të burrave, ndërsa në komunat Pejë, Gjilan, Prishtinë, Fushë Kosovë, Viti, Obiliq, Gjakovë dhe Mitrovicë e Jugut, gjinia e të punësuarve në sektorin publik del të jetë dukshëm më e lartë në favor të grave.


**Fig. 18 Numri i të punësuarve burra dhe gra në sektorin publik sipas komunave**



Burimi: Kërkesë për qasje në të dhëna publike në listat e dorëzuara nga komunat në MF

Hendek më i madh haset në shpërndarjen e buxhetit, shikuar sipas gjinisë në sektorin publik. Gjatë një viti, në të gjitha komunat e Kosovës, për paga ofrohen 262,505,503 euro, nga këto, 134,905,810 euro shkojnë në pozitat e mbajtura nga burrat, dhe 127,599,693 euro për pozitat e mbajtura nga gratë. Komunat ku dukshëm shpenzohet buxheti për paga në favor të burrave janë: Ferizaj, Deçani, Hani i Elezit, Skenderaj, Podujeva, Vitia, Dragashi, Kaçaniku, Kamenica dhe Malisheva. Ndërsa komunat ku dukshëm shpenzohet buxheti për paga në favor të grave janë: Prishtina, Peja, Gjlani, Fushë Kosova, Suhareka, Obiliqi, Gjakova dhe Mitrovica e Jugut.

**Fig. 19 Shpërndarja e buxhetit për gra dhe burra nga kategoria e pagave paraqitur në përqindje sipas komunave për vitin 2023 (në Euro)**




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

## 5. Buxheti

Buxheti i të gjitha komunave të Kosovës për vitin 2023 (i planifikuar) është 658 milionë euro. Krahasur me një vit më herët, shuma e buxhetit është rritur për 102 milionë euro.

**Fig. 20 Buxheti total për komuna 2015 - 2023**




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

Komunat që kanë shënuar rritje të buxhetit në vlerë mbi pesë milionë euro në krahasim me vitin paraparok janë: Gjakova, Prishtina, Prizreni dhe Skenderaj.

**Fig. 21 Buxheti total sipas komunave për vitet 2022 dhe 2023 (i planifikuar)**


■ 2022 ■ 2023



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

Kategoria që më së shumti ka rritje të buxhetit më 2023 krahasuar me vitin 2022 është kategoria e investimeve kapitale. Në vitin 2022, shuma e përgjithshme e komunave në dispozicion për investime kapitale ka qenë 148 milionë euro, përdërisa në vitin 2023, kjo shumë është për afërsisht 68 milionë euro më e lartë.

**Fig. 22 Buxheti i ndarë sipas kategorive kryesore buxhetore 2015 – 2023**




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

Gjatë vitit 2022, shpenzimet e mjeteve në vlerën 100% të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale sipas komunave kanë shënuar Ferizaj dhe Malisheva, ndërsa mbi 90% Viti, Suhareka, Rahoveci, Obiliqi, Mitrovica e Veriut, Gjilani dhe Drenasi. Ndërsa përqindja më e ulët është shënuar në Fushë Kosovë me 26%, Prishtinë 28%, Zubin Potok 41% dhe Kllokot 42%. Përqindja e shpenzimit të buxhetit në kategorinë e shpenzimeve kapitale në Fushë Kosovë dhe në Prishtinë është me e ulta në gjashtë vitet e fundit.




**Fig. 23** Niveli i shpenzimit të buxhetit për investime kapitale sipas komunave 2017 -2022



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

Të hyrat vetanake të komunave vazhdojnë të mbesin të ulëta. Nga gjithsej buxheti që kanë komunat në dispozicion (658 milionë euro për vitin 2023) vetëm 14.9% e tyre (apo 98,519,262 euro) janë të planifikuara të inkasohen nga komunat. Nga 98 milionë euro të planifikuara për t'u inkasuar, 34 milionë janë të parapara për t'u mbledhur vetëm nga komuna e Prishtinës.


**Fig. 24** Të hyrat e përgjithshme vetanake të komunave 2017 - 2023 (të planifikuara)



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

Komunat e Kosovës po përballen me një nivel të lartë të borxheve të pambledhura, të cilat nuk po arrijnë t'i mbledhin nga qytetarët dhe bizneset. Niveli më i lartë i borxhit është në tatimin në pronë. Kështu, 34 komunat e Kosovës kanë borxh të pambledhur prej 220 milionë eurove. Kjo shifër është për 20 milionë euro më e lartë në 2022 krahasuar me vitin e mëparshëm, kur niveli i borxheve të pambledhura ishte pak më i lartë se 200 milionë euro. Komuna me nivelin më të lartë të borxheve të pambledhura është Prishtina, e cila ka afro 70 milionë euro të pambledhura. Pastaj, vjen Peja me afro 22 milionë euro, Prizreni me afro 19 milionë euro dhe Ferizaji me 16 milionë euro, tre milionë më shumë se Gjilani, e cila nuk ka arritur të mbledhë 13 milionë euro. Krahasimi mes vitit 2021 dhe 2022 tregon se asnjë komunë nuk ka arritur të zbrisë nivelin e borxhit.

**Fig. 25 Borxhet që qytetarët, bizneset dhe subjektet e tjera ju kanë komunave 2021 -2022**




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e raporteve financiare të Ministrisë së Financave.

## 6. Ekonomia

Gjatë vitit 2022, në të gjitha komunat e Kosovës janë regjistruar afro 11 mijë biznese. Edhe në tri vitet parapara, ky numër ka qenë i përafërt.


**Fig. 26 Numri i bizneseve të regjistruara gjatë viteve 2011-2022**



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Por, krahasur me vitin 2021, në 2022, në Prishtinë janë regjistruar afro 500 biznese me pak, ndërsa në Prizren 149 dhe po ashtu më pak biznese të regjistruara ka pasur edhe në Gjiilan, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut dhe Pejë.


**Fig. 27 Numri i bizneseve të regjistruara sipas komunave 2021 - 2022**



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Nga viti 2011 deri në vitin 2022, numri më i madh i bizneseve të shuara ishte në vitin 2012, kur janë shuar 4,123 biznese, ndërsa në vitin 2022 janë shuar 1,525 biznese.

**Fig. 28 Numri i bizneseve që shuhet gjatë një viti**




Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Numri më i madh i bizneseve të shuara është në komunat e mëdha. Ndërsa për dallim nga vitet e tjera, në Skenderaj është hasur rritje për 55% të bizneseve të shuara gjatë 2022 në krahasim me vitin 2021.

**Fig. 29** Numri i bizneseve të shuara sipas komunave gjatë vitit 2021 – 2022

■ 2021 ■ 2022




Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës

Sipas të dhënave të ATK-së, në gjithë Kosovën, deri në fund të vitit 2022 janë të punësuar 397,005 persona, apo 35,074 persona më shumë (9.7%) se një vit më herët. Sipas vlerësimit të popullsisë 2021, në Prishtinë kanë dalur 219,017 banorë, ndërsa nga të dhënat e ATK-së në vitin 2022 në Prishtinë janë të punësuar 215,288 persona. Pas Prishtinës, komuna e dytë për numrin e punëtorëve vjen Ferizaj, pastaj Prizreni, Peja, Gjilani e Gjakova. Numër më i madh i të punësuarëve del të ketë në Graçanicë se sa në Mitrovicën e Jugut, përdherisa numri i banorëve në këto dy komuna është në diferencë të madhe. Numri më të vogël të të punësuarëve ka në Junik, Dragash, Novobërdë, Partesh, Klllokot dhe Ranillug. Deri në fund të vitit 2022, në të gjitha komunat e Kosovës janë 176,330 biznese aktive, apo 23,136 më shumë se një vit më herët. Numri më i madh i bizneseve të evidentuara në listen e ATK-së janë në Prishtinë me gjithsej 46,568 biznese, pastaj vjen Prizreni me 12,593 subjekte, Ferizaj me 10,828 subjekte, Gjilani 9,056 subjekte, Peja me 8,402 subjekte, Gjakova me 7,125 dhe Fushë Kosova me 4,311 subjekte.

**Fig. 30** Numri i të punësuarve në sektorin privat sipas komunave 2021 -2022


■ 2021 ■ 2022



Burimi: ATK

Sipas të dhënave publike të ATK-së rreth aktivitetit ekonomik të bizneseve, del se në vitin 2022, bizneset me qarkullimin më të madh janë nga Komuna e Prishtinës me pjesëmarrje prej 41.7% në aktivitetin e tërësishëm ekonomik në vend, Graçanicës me 10.6%, Ferizajt me 6.5%, Prizrenit me 5.6%, Fushë Kosovës me 4.4%, etj. Sipas sektorëve, në vitin 2022 del se në nivel vendi mbizotëron anktiviteti në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë (48.4%), industria përpunuese (13.3%), furnizimi me rrymë (8.7%), ndërtimtaria (8.5%), etj.

**Fig. 31 Qarkullimi vjetor i bizneseve sipas komunave 2021 -2022 (në Euro)**




Burimi: ATK

## 7. Shërbimet publike

Sipas raportit të performancës që e harton Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në vitin 2021 (matje e bërë në gjysmën e parë të vitit 2022), performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 109 tregues të matjes është 56.8%, një performancë më e ulët për 0.26 pikë përqindje krahasuar me 2020. Referuar përqindjes sipas fushave, nevoja më e madhe për rritjen e performancës shprehet në këto fusha: përfaqësim të barabartë gjinor (38.02%), kanalizim (35.49%), parkingje (47.04%), zhvillim ekonomik lokal (44.45%), planifikim hapësinor dhe shërbime shëndetësore.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i performances së komunave të republikës së Kosovës për vitin 2021. Fq 9 dhe 19. Burimi: <https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/>


**Fig. 32** Mesatarja e komunave shprehur në përqindje në përmbushjen e planeve vjetore në 19 fusha sipas kompetencave komunale



Burimi: Raporti i performancës MAPL 2022

Gjatë vitit 2021, komunave u janë parashtruar 2,055,349 kërkesa për shqyrtim, nga të cilat janë shqyrtuar 1,950,299 kërkesa. Mesatarja e trajtimit të kërkesave për komunë është 25,710 kërkesa. Këtu përfshihen kërkesat për leje të ndryshme komunale, dokumentet e gjendjes civile, kërkesat për qasje në informata, kërkesat qytetare për financim dhe adresim në organet përgjegjëse të komunës. Referuar performancës sipas komunave në këtë fushë, përqindja më e lartë në përmbushjen e treguesve është në Komunën e Suharekës, Lipjanit, dhe Kamenicës, kurse më e ulëta në Komunën e Graçanicës, Novobërdës dhe Prizrenit.

**Fig. 33** Përqindja e përmbushjes së kërkesave të parashtruara nga qytetarët për praninë të shërbimeve nga komunat gjatë vitit 2021 (shprehur në përqindje)



Burimi: Raporti i performancës MAPL 2022

Ndërsa sa i përket zonave të lidhura me rrugë të asfaltuara/rregulluara, përfshirë shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik si dhe shenjëzim horizontal dhe vertikal, gjendja më e mirë ka dalë në Obiliq, Vushtri dhe Suharekë, ndërsa me e keqe në Dragash, Fushë Kosovë dhe Graçanicë.


**Fig. 34 Rrugë të asfaltuara/rregulluara, përfshirë shtigje të biçikletave, shenjëzim sipas komunave në 2021 (shprehur në përqindje)**



Burimi: Raporti i performancës MAPL 2022

Sa i përket furnizimit me ujë të pijes për amvisri dhe biznese, përfshirë realizimin e investimeve të planifikuara për ujë të pijes, gjatë vitit 2021 janë vlerësuar lartë Istogu, Peja dhe Obiliqi, ndërsa më së keqi janë ranguar Vitia, Gjilani dhe Vushtrria.


**Fig. 35 Furnizimi me ujë dhe përmbushja e planeve për shtrirje/zavendësim të rrjetit të ujësjellësëve sipas komunave gjatë 2021 (shprehur në përqindje)**



Burimi: Raporti i performancës MAPL

Nga 19 fusha ku matet performanca e komunave, fusha me performancën me të dobët ka dalur shtrirja dhe menaxhimi i rrjetit për ujëra të zeza dhe kanalizim. Relativisht mirë janë ranguar Obiliqi, Ferizaj dhe Prishtina, ndërsa më së keqi qëndrojnë Ranillugu, Gjilani, Vitia.


**Fig. 36** Përmbushja e planeve për shtrirje/zavendësim të rrjetit të kanalizimeve sipas komunave gjatë 2021 (shprehur në përqindje)



Burimi: Raporti i performancës MAPL

Shkalla e mbulueshmërisë së zonave me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave dhe niveli i përmbushjes së planeve vjetore për menaxhimin e mbeturinave, tri komunat me mirë të ranguara janë Mitrovica e Jugut, Obiliqi dhe Lipjani, ndërsa në fund të rangimit janë Mamusha, Shtërpca dhe Kamenica.

**Fig. 37** Mbulimi i zonave me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave dhe niveli i përmbushjes së planit vjetor në fushen e menaxhimit të mbeturinave (shprehur në përqindje)



Burimi: Raporti i performancës MAPL


## 8. Transparenca

Transparenca buxhetore e komunave në vitin 2021 është në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara. Mesatarja e pikëve të Indeksit të Transparencës Buxhetore për të gjitha komunat për vitin 2021 është 53.1 pikë (nga 100 pikë gjithsej). Nga 38 komuna, 65% apo 25 prej tyre kanë kaluar nivelin mesatar të pikëve të indeksit (mbi 50 pikë). Maksimumin e pikëve të indeksit prej 100 pikë për vitin 2021 e kanë arritur tri komuna (Komuna e Mitrovicës së Jugut,




Rahovecit dhe Lipjanit). Këto tri komuna kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel' ose 'Word', me përjashtim të dokumenteve me përmbajtje tekstuale që janë publikuar edhe në formate tjera si 'PDF' apo dokument të skanuar. Transparencë të lartë buxhetore në vitin 2021, bazuar në Indeksin e Institutit GAP, ka treguar edhe Komuna e Hanit të Elezit e cila ka mbledhur 95 pikë dhe e cila ka publikuar të gjitha dokumentet, mirëpo, për shkak të formatit të disa dokumenteve nuk ka marrë pikët maksimale. Ngjashëm edhe Komuna e Drenasit e cila është ranguar në vendin e pestë me 87.5 pikë. Komunat e Zubin Potokut, Zveçanit, Parteshit dhe Leposaviqi janë vlerësuar me zero pikë në Indeks, meqenëse nuk kanë publikuar asnjë dokument dhe nuk janë përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore.

**Fig. 38** Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2021 sipas pikëve të fituara (shprehur në përqindje)



Burimi: Instituti GAP

**Fig. 39** Trendi i transparencës buxhetore të komunave nga 2016 deri në 2021 (shprehur në përqindje)



Burimi: Instituti GAP

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,  
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

---

Instituti GAP përkrahet nga:



Ky projekt mbështetet nga:





